

# FJALA IME



# FUQIA IME

## LIRI, POR EDHE LIGJE TË MIRA

EROLINDA (15), VALJONA (15), EDONA (15), DIJAN (14), ADNAN (14), GRANIT (14), FLORENTINA (15)



### Në sistemin demokratik, liria e secilit qytetar është e përcaktuar sipas ligjeve. Se si bëhet kjo do t'iu tregojmë ne që dijmë ta ruajmë demokracinë e shtetit tonë

Sistemi demokratik është sistemi i vetëm i cili siguron lirinë e shprehjes, lirinë e lëvizjes, lirinë e zgjedhjes, etj. Të gjitha këto liri janë të përcaktuara me ligje, duke e ditur se mund të ketë edhe qytetarë të papërgjegjshëm të cilët do të mund t'i keqpërdornin këto liri. Prandaj, themi se demokracia është sistemi



Aty ku u shfaq për herë të parë demokracia

që ka më së shumti ligje dhe rregulla. Ajo është formë e udhëheqjes e cila kërkon vazhdimisht angazhimin e të gjithë qytetarëve. Pa qytetarë të tillë demokracia nuk mund të funksionoj. Por as qytetarët pa demokraci nuk do të mund të ishin të lirë dhe nuk do t'i gëzonin të drejtat që veçse i gëzojnë. Diskriminimi në demokraci është fjalë që dëgjohet shumë rrallë, pasi që nuk zë vend në këtë sistem. Në demokraci, unë Adnani

dhe shoqja ime Edona jemi të barabartë, ashtu si të gjithë shokët dhe shoqet tona. Kjo nënkupton se fjala ime nuk ka peshë më të madhe se fjala e Edonës dhe vendimmarrja na takon të dyve pa asnjë dallim.

Demokracia është sistemi që na jep liri dhe vlerë. Atëherë, duam të potencojmë se qytetarët duhet të dijnë ta mbajnë, ta ruajnë dhe ta zhvillojnë atë. Zhvillimi i demokracisë nuk mund të vie pa bashkëpunim, pa tolerancë, pa respekt, pa paqe dhe pa respektimin e ligjeve.

Demokracia është shfaqur në shekullin VI para erës sonë dhe ka arritur të mbijetoj deri më tani. Këtë e kemi arritur falë punës së palodhshme të qytetarëve. Andaj, meqenëse demokracinë e kemi, duhet të provojmë çdo herë ta fuqizojmë atë. Ne kemi nevojë për një demokraci më të zhvilluar. Prandaj, kontributi i secilit do të ishte vlerë e shtuar.


Mendime të ndryshme, njerëz të ndryshëm, por respekt i njëjtë. Mbi të gjitha, të barabartë para ligjit.




Të vendosur për ta ndërtuar tutje të ardhmen



Në demokraci, ky koncept zë vend të veçantë




E drejta për të ngritur zërin tonë ndaj padrejtësisë




Por, kur të arrij moshën 18 vjeçare, ashtu siç ligji e thotë



Votimi është përgjegjësi që duhet të përmbushet



Po, po, qytetarët aktiv nënshkruajnë edhe peticione





Ata po ashtu, zbatojnë rregullat e komunikacionit



## E DREJTA E ZGJEDHJES

GRANITA (15), ENGJI (14), ILIR (14), JAKUP (15), ELTON (14), QENDRIM (15)



### Ndryshimi vjen nga zgjedhjet që i bëjmë

Ne jemi disa nga nxënësit e klasës së IX-të, nga Deçani. Sof me shumë entuziazëm kemi ardhur në Punëtorinë e Demokracisë. Në grupin tonë patëm mundësi të diskutim më shumë rreth zgjedhjeve. Kështu, diskutimin e filluam duke i treguar profesionet që do të dëshironim t'i kishim në të ardhmen. Eltoni tregoi se ai është në një klub të futbollit dhe në të ardhmen synon të bëhet futbollist. Shoqja jonë Granita dëshiron që në të ardhmen të bëhet mësuese, Qendrimi dëshiron që të bëhet polic, Jakupi dëshiron që të punoj si ekonomist në bankë, Engjit i pëlqen të bëhet këngëtare, kurse Iliri dëshiron që të bëhet ushtar në të ardhmen. Për shkak që jetojmë në një vend demokratik, ne e kemi të drejtën për të zgjedhur profesionet që ne i pëlqejmë. Në jetën tonë hasim në situata të shumta ku duhet të zgjedhim. Prandaj, duhet të mendojmë mirë për të bërë një zgjedhje, sepse ato do të ndikojnë jetën tonë.

Në demokraci, zgjedhjet e lira janë shtyllë kryesore. Në shtetin tonë ka dy lloje të zgjedhjeve që organizohen. Ato janë zgjedhjet qendrore, ku populli i voton kandidatët për deputetë; dhe zgjedhjet lokale, ku qytetarët i votojnë kandidatët për kryetarë të komuneve dhe për asamblistë.

Për shkak që nga këto zgjedhje varet e ardhmja e popullit, përgjatë votimit në procesin zgjedhor, nuk duhet të ketë manipulime. Zgjedhja duhet të bëhet vetë dhe në mënyrë të pavarur.

Ne si fëmijë ende nuk kemi të drejtë të votojmë në procesin zgjedhor. Kur do t'i mbushim 18 vjet, atëherë do të kemi mundësi të zgjedhim përfaqësuesit tanë. Duke parë se sa është e rëndësishme vota, ne do të jemi qytetarë të përgjegjshëm dhe do të marrim pjesë në çdo proces zgjedhor.

Grupi ynë shpreson që edhe ju të dashur lexues do ta kuptoni rëndësinë që e ka vota e secilit prej neve.



Ne punojmë duke bashkëpunuar



Ardhmëria varet nga zgjedhjet që ne i bëjmë


# TË JEMI AKTIV PËR TË MIRËN E TË GJITHËVE

QENDRIM (16), NJOMZA (14), ELSA (14), RINESA (14), GRANIT (14), ARMATIN (14)



**Ne nxënësit e klasës sonë kemi një shembull konkret se si mund të jemi aktiv në vendin tonë. Për ta kuptuar se për cilin shembull bëhet fjalë, vazhdoni të lexoni këtë artikull**

Ne, nxënësit e klasës së IX-të nga shkolla e mesme e ulët „Heronjtë e Dukagjinit“ një ditë vendosëm që të jemi produktiv dhe aktiv për të mirën e të gjithëve.



Kështu, me ndihmën e njërit prej mësimitdhënësve tanë, mbollëm pisha në oborrin e shkollës. Kujtojmë se ishin dy ditë të lodhshme, por në të njëjtën kohë edhe argëtuese. Pjesa më e mirë ishte ndjenja që përjetuam pasi përfunduam mbjelljen. U ndjemë krenarë me veten dhe të lumtur sepse punën tonë do ta gëzonin edhe gjeneratat e ardhshme.

Kjo ishte hera e parë që ne si nxënës kemi bërë punë vullnetare. Na pëlqeu aq shumë sa që kemi vendosur që punë të tilla për të mirën e komunitetit tonë të bëjmë gjithmonë. Kjo është mënyra më e mirë për të

pasur një shtet të suksesshëm. Të punojmë, të angazhohemi dhe të jemi aktiv, të gjithë ne.

Disa nga mënyrat për të qenë aktiv janë edhe: pjesëmarrja në zgjedhje, tubime dhe protesta paqësore, pastrimi i ambientit, nënshkrimi i peticioneve, etj. Të gjitha këto veprime janë aq të thjeshta, por tejet të rëndësishme për vendin tonë dhe të gjithë qytetarët.

Ne dëshirojmë t'i përmendim disa të drejta që i kemi të gjithë qytetarët. Përfshijmë këtu: të drejtën e shkolimit, të votës, të shprehjes së lirë, të strehimit, atë të familjes, etj. Mirëpo, nuk duhet të harrojmë asnjëherë përgjegjësitë që i kemi ne. Disa nga to janë: pagesa e taksave, respektimi i ligjeve, ruajtja e pronave publike, pjesëmarrja në zgjedhje, etj.

Ne fuqishëm besojmë se pas këtij artikulli do ta kuptoni se gjithçka që bëjmë për vendin tonë, në fakt e kemi bërë për veten tonë. Ne dhe vendi ynë, jemi një.



**Ne, autorët krenarë të këtij artikulli**





## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Heronjtë e Dukagjinit“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: IX  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Glllogjan, Deçan